



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE
EMERGJENCËS

07-104/02- 11973 /24

Datë: 23.05.2024



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Statutin e Komunës së Kaçanikut 01 Nr.60/01-12895/20 nenin 78 pika 6, Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, Rregulloren 01Nr.07-60/01-17890/19 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, dhe duke marr parasysh kërkesat e qytetarëve për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, bën këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Për Ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Mbeturinave në Zonën e III-të.

1. Përmes kësaj shpallje publike, njoftohen të gjithë operatorët ekonomik privat, se mund të aplikojnë për ofrimin e shërbimit të Menaxhimit të Mbeturinave në zonën e III-të për periudhën njëvjeçare 2024-2025.
2. Ofrimi i shërbimit për zonën e III-të përfshinë këto vendbanime:
 - a. Begracë dhe
 - b. Kaçanik i Vjetër
3. **KRITERET PËR OPERATORIN EKONOMIK PRIVAT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE**
 - Licencë valide për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
 - Certifikatë e biznesit për veprimtarinë e lartcekur,
 - Kontratë valide për deponim të mbeturinave me KMDK-në (Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës) apo deponi tjetër e licencuar,
 - Licencë për zhvillim të kësaj veprimtarie në regjionin tonë (e preferueshme),
 - Referenca për veprimtarinë e lartcekur (3 vitet e fundit).

4. KAPACITETET TEKNIKE

- 2 kamion kompaktor minimum 7m³,
- 1 kamion për bartjen e mbeturinave nën 4m³,
- Minimum 2 vozitës kamioni kategoria 'C'
- Nr. e punëtorëve të nevojshëm për grumbullimin e mbeturinave,
- Punëtorinë për servisim të automjeteve apo kontratë valide me punëtori të licencuar.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zyrën e pranimi.

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, kërkesa do të refuzohet.

Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit, mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit të shpalljes publike.



Ramadush Osmani

drejtor i DSHPE-së